


Bibël për fëmijët
paraqet



Ushtria e
Vogël e
Gideonit



Shkruar nga: Edward Hughes

Ilustruar nga: Janie Forest' Alastair Paterson

Adaptuar nga: Ruth Klassen

Përkthyer nga: Arianit & Valbona Iljazi


Prodhuar nga: Bible for Children

www.M1914.org

©2021 Bible for Children, Inc.

E drejta e kopjimit: Mund të bëni kopje ose ta shtypni këtë histori, nëse nuk do ta shitni.






Pasi Jozueu
vdiq, i gjithë
populli i
Izraelit nuk
iu bind
Perëndisë
dhe e la

Atë jashtë
jetëve të
tyre.





Perëndia
lejoi
Madianitët
fqinj, të
digjnin të
korrat dhe
shtëpitë e

Izraelitëve.
Izraelitëve iu desh
të jetonin nëpër
shpella.



Një Izraelit, Gideoni,
duhet të kishte një
vend të fshehtë
për të rritur
grurin.



Ai e shinte grurin në
një shtypësë rrushi
të fshehur, nën
një pemë të
madhe.




Madianitët nuk e dinin
vendin - por, Perëndia e
dinte. Perëndia
dërgoi një
Engjëll me


një mesazh për
Gideonin.




Perëndia, donte që Gideoni të
shkatërronte imazhin e një
perëndie të rremë të atit të
tij dhe ti ndërtonte një altar
Perëndisë së vërtetë.




Megjithëse Gideoni kishte frikë se bashkëfshatarët do ta vrisnin, ai bëri atë që Perëndia e urdhëroi.



Perëndia gjithashtu donte, që
Gideoni të udhëhiqte ushtrinë e
Izraelit kundër Madianitëve të ligj.
Por, Gideoni kishte
frikë.



Ai kërkoi një shenjë të veçantë që
Perëndia ishte me të. Pastaj, ai
vendosi një lëkurë deleje mbi tokë.





"Nëse ka vesë vetëm
mbi postiqen, dhe gjithë
vendi është i thatë", ...





... u lut
Gideoni, "atëherë
unë do ta di, që Ti do ta
shpëtosh Izraelin nëpërmjet
dorës time, siç Ti ke thënë".





Në mëngjes, vendi
ishte i thatë, por LËKURA
ISHTE E LAGUR, QULL FARE!



Gideoni ende dyshonte.
Tani, ai donte që Perëndia
të dërgonte vesë mbi
vendin, por jo përmbi
lëkurën.



Mëngjesin tjetër - vendi ishte
i njomë nga vesa, por
LËKURA ISHTE E THATË!



Gideoni filloi me një ushtri prej 32000 burrash. Perëndia e shkurtoi numrin e ushtrisë në vetëm 300 burra.

~~32000~~

~~10000~~

3000 ✓



Perëndia nuk donte që Izraeli të thoshte, "Dora ime më ka shpëtuar". Vetëm Perëndia është Shpëtimtari i Izraelit.


~~320000~~

~~100000~~


3000 ✓



Duke e ditur që, Gideoni kishte ende frikë, Perëndia e la atë që fshehtazi të dëgjonte bisedën e një ushtari Madianit me një tjetër, për një ëndërr të çuditshme.



Në ëndërr, një bukë rrokullisej kundër një tende Madianite dhe e shkatërronte atë.





Roja tjetër u tmerrua. "Kjo është... shpata e Gideonit...", bërtiti ai. Kur Gideoni dëgjoji ëndrrën dhe kuptimin e saj, ai e kuptoi se Perëndia do ti jepte atij fitoren.



Gideoni bëri në plan të sulmojë
gjatë natës. Ai i dha çdo ushtari një
bori, dhe qypa
bosh me pishtarë
brenda. Ata
rrethuan ushtrinë
Madianite.



Me sinjalin e Gideonit, ushtarët u
ranë borive, thyen qypat dhe ndezën
pishtarët e tyre. Çfarë zhurme!
Çfarë rrëmuje! Madianitët
e frikësuar u çuan dhe ia
mbathën nga sytë këmbët.



Pas kësaj fitoreje të madhe,
njerëzit e Izraelit i kërkuan
Gideonit të sundonte mbi ta.



“Unë, nuk do të sundoj mbi ju ...
Perëndia do të sundojë mbi ju”, u
përgjigj Gideoni.



Ai e dinte, që vetëm Perëndia ka të drejtë të sundojë mbi jetët e njerëzve.



Ushtria e Vogël e Gideonit

Një tregim nga Fjala e Perëndisë, Bibla

e marrë nga

Gjyqtareve 6-9

"Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u jep mendje njerëzve të thjeshtë."

Psalmet 119:130



Fund



Ky tregim nga Bibla na tregon për Perëndinë tonë të mrekullueshëm i cili na krijoi dhe dëshiron që ne ta njohim Atë.

Perëndia e di që ne kemi bërë gjëra të këqija, të cilat Ai i quan mëkate. Dënimi për mëkatin është vdekja, por Perëndia ju do juve aq shumë sa që dërgoi Birin e Tij të vetëm, Jezusin, që të vdesë në Kryq dhe të dënohet për mëkatet tuaja. Pastaj Jezusi u ringjall dhe u ngrit lart në Qiell! Nëse beson në Jezusin dhe i kërkon Atij të t'i falë mëkatet e tua, Ai do ta bëjë atë! Ai do të vijë dhe do të jetojë në ty, dhe ti do të jetosh me Të përgjithmonë.



Nëse ti beson se kjo është e
vërteta, drejtoju Perëndisë kështu:
Jezus i dashur, unë besoj se Ti je Perëndia i
bërë njeri për të vdekur për mëkatet e mia,
dhe që Ti u ngjalle sërish. Të lutem, eja në
jetën time dhe fal mëkatet e mia, në mënyrë
që unë të kem jetë të re dhe një ditë të jem
me Ty, përgjithmonë. Më ndihmo, të të bindem
dhe jetoj për Ty, si fëmija Yt. Amen.

Lexo Biblën dhe bisedo me Perëndinë
çdo ditë! Gjoni 3:16

